



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR TË BASHKISË LEZHË TË PROPOZUAR
NGA KOALICIONI "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE" Z.PJERIN ZEF NDREU PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 15.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Lezhë z. Pjerin Zef Ndreu të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 07.05.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane". Sipas marrëveshjes së Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", kryetari i Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Edi Rama do të jetë personi i cili do të autorizojë



Nr. 399 i Vendimit

Data 15.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Vlorë të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", z. Pjerin Zef Ndreu për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

personat përgjegjës për të firmosur në emër të koalicionit kërkesën për rregjistrimin e kandidatëve për Kryetar Bashkie.

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" ka depozituar në KQZ Kërkesën për rregjistrimin e z. Pjerin Zef Ndreu si kandidat për kryetar të bashkisë Lezhë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të rregjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkisë Lezhë, pasi Bashkia Lezhë, administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:

1. Kërkesë për rregjistrimin e z. Pjerin Zef Ndreu si kandidat për kryetar të bashkisë Lezhë;
2. Deklaratat e kandidatit i cili deklaron se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për Kryetar në Bashkinë Vlorë, të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019;
3. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
4. Kopje e letërnjoftimit të Z. Pjerin Zef Ndreu si kandidat për kryetar të bashkisë Lezhë sipas së cilës rezultoi se z. Pjerin Zef Ndreu është me vendbanim në Bashkinë Lezhë;
5. Jetëshkrimin e z. Pjerin Zef Ndreu si kandidat për kryetar të bashkisë Lezhë;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për të kandidatit për kryetar bashkie. KQZ gjithashtu ka publikuar formularin e vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezultoi z. Pjerin Zef Ndreu, ka deklaruar në pikën 4 se ka qënë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një veprë penale, "për përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike". Në pikën 5 ka deklaruar masën shtrënguese të sigurisë personale "detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore". Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë për veprën penale të sipërcituar, parashikuar nga neni 275 kodi penal, ka vendosur pafajësi.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore, sipas së cilës rezultoi se z. Pjerin Zef Ndreu është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se dhënat e deklaruara nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit sipas ligjit nr. 138/2015. Gjithashtu KQZ ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.



Nr. 399 i Vendimit

Data 15.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Vlorë të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", z. Pjerin Zef Ndreu për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 15.05.2019, verifikoi dokumentacionin e kandidimit të z. Pjerin Zef Ndreu si kandidat për kryetar të bashkisë Lezhë, të depozituar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, neni 165 nenin 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S I:

1. Të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Lezhë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, z. Pjerin Zef Ndreu të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 399 i Vendimit

Data 15.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Vlorë të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", z. Pjerin Zef Ndreu për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.